



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## DREJTORIA E PLANIFIKIMIT URBAN DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

### Procesverbal

### Hapja zyrtare e shqyrtimit publik dhe prezantimi i Projekt Dokumentit të Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 2024-2029 me qytetarë i mbajtur më 03/12/2024

Takimi filloi në orën 10:00, në sallën e Kuvendit Komunal.

Takimin e hapi dhe e udhëheqi **znj. Artiola Zeneli, Zyrtare për Mbrojtjen e Mjedisit në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit.**

Në takim ishin të pranishëm një numër i qytetarëve (rreth 10 - bashkëngjitur lista e pjesëmarrësve) dhe zyrtarë komunal.

**znj. Artiola Zeneli, Zyrtare për Mbrojtjen e Mjedisit,** e hapi takimin duke përshëndetur të pranishmit dhe duke ju dëshiruar mirëseardhje, ndër të tjera theksoi arsyen për mbajtjen e këtij takimi.

Ashtu siç edhe jeni të informuar, në këtë takim si temë është paraparë:

#### ➤ **Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2024-2029.**

Të nderuar të pranishëm sipas Vendimit për vënie në shqyrtim publik të Projekt Dokumentit të Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 2024-2029 në Komunën e Podujevës lidhur me zhvillimin e këtij projekti, hapjen e debatit publik po e realizojmë sot dhe ju falënderoj të gjithëve për kohën tuaj. Më lejoni që të prezantoj draft Planin Lokal të Veprimit në Mjedis 2024-2029, pastaj do të zhvillohet debati nga i cili do të marrim me seriozitet vërejtjet, propozimet, sugjerimet dhe rekomandimet tuaja në mënyrë që ta miratojmë formën më të mirë të Planin Lokal të Veprimit në Mjedis 2024-2029 për të gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës.

#### **Filloi prezantimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 2024-2029;**

Ky draft përmban përshkrimin dhe analizën e gjendjes ekzistuese të mjedisit, identifikimin e problemeve kryesore në mjedisin e komunës së Podujevës, pra dokumenti është bazë e informatave, rregullave dhe kushteve për përmirësimin e gjendjes së mjedisit.

#### **Qëllimi i përgjithshëm i “Planit Lokal për Veprim në Mjedis 2024-2029” është:**

- Të bëj vlerësimin dhe analizën e gjendjes ekzistuese të mjedisit dhe ndikimeve në mjedis
- Të identifikoj dhe përcaktoj problemet dhe mangësitë kryesore mjedisore
- Të identifikoj dhe përcaktoj prioritetet kryesore që do të adresohen në kuadër të PLVM-së për periudhën 5 vjeçare

- Të planifikohen dhe përcaktohen afatet, aktivitetet dhe projektet që do të ndërmerren për adresimin e prioriteteve të identifikuara, si dhe indikatorët përkatës për monitorimin e ndotjes duke siguruar burime të qëndrueshme për përdorime afatgjate

**Problemet Kryesore Mjedisore të evidentuara janë:**

- Ndotja e ujërave - nga deponimi ilegal i mbeturinave, metalet e rënda, faktorët natyrorë dhe erozioni;
- Ndotja e ajrit – nga numri i madh i automjeteve, djegia e mbeturinave, pluhuri nga aktivitetet ndërtimore, gazrat e dëmshme dhe aromatike;
- Humbja e tokës – nga përdorim jo racional i tokës ndërtimor, humbja e tokës bujqësore, përgjatë reshjeve me intensitet të lartë dhe erozionit;
- Zvogëlimi i biodiversitetit – nga dëmtimi, fragmentimi dhe humbja e habitateve të veçanta të florës dhe faunës nga faktori antropogjen dhe dukuritë natyore

Në kuadër të këtij plani është përgatitur edhe harta online në të cilën qytetarët mund të qasen për t’i parë objektet e mbrojtura natyrore.

- Tani është hapësirë për pyetje nga pjesëmarrësit.

**z. Azdren Llughaliu**, parashtroi pyetjet si në vijim;

-A është bërë një vlerësim se sa ndikojnë në mjedis ndërtimet e larta?

**znj. Artiola Zeneli, Zyrtare për Mbrojtjen e Mjedisit**, sqarim parafolësit, theksoi;

-Kjo pjesë nuk është përfshi në këtë plan pasi ndërtimet e larta trajtohen me Leje Mjedisore Komunale konform Udhëzimit Administrativ 01/2017 për dhënien e Lejeve Mjedisore Komunale, ku me këtë leje trajtohen të gjitha ndikimet e mundëshme në mjedis dhe shëndet të popullatës.

Si përfundim, **znj. Artiola Zeneli**, potencoi meqenëse nuk ka të pranishëm tjerë që kanë kërkuar fjalën, se debati publik do të vazhdoj sipas kalendarit të paraparë dhe poashtu janë njoftuar se komentet mund ti dërgojnë të shkruara në e-mail: [artiola.zeneli@rks-gov.net](mailto:artiola.zeneli@rks-gov.net) dhe [remzi.kodraliu@rks-gov.net](mailto:remzi.kodraliu@rks-gov.net), falënderoj të gjithëve për prezencën dhe për kontributin e dhënë në këtë proces. Takimin po e përmbyllim. Gjithë të mirat!

**Takimi u mbyll në ora 10:45.**

*Shtojcë* – Tabela e pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

Femra	8
Meshkuj	2
Totali	10



Foto 1. Fotografi gjatë mbajtjes së takimit.

Podujevë,  
03/12/2024

Procesverbalin e mbajti,  
Remzi Kodraliu



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Lista e pjesëmarrësve në debatin publik të Draft-Planit Lokal për Veprim në Mjedis 2024-2029

	Emri dhe mbiemri	Vendbanimi	Nr.telefonit	Nënshkrimi
1	Jehone Agriqi	Podujevë	[Redacted]	[Signature]
2	Nasrije Haliti	Podujevë	[Redacted]	[Signature]
3	Valdrina Potoku	Podujevë Bradash	[Redacted]	[Signature]
4	Filloreta Gjaku	Bajçinë	[Redacted]	[Signature]
5	Asdren Ligalliu	Podujevë	[Redacted]	[Signature]
6	Diellza Rama	Podujevë	[Redacted]	[Signature]
7	Hamide Behtiri	Allanik	[Redacted]	[Signature]
8	Mirlinda Zulfaj	Podujevë	[Redacted]	[Signature]
9	LRIDONA PPAJNYANI	PODUJEVË	[Redacted]	[Signature]
10	REMZI KODRALIU	PODUJEVË	[Redacted]	[Signature]
11				
12				
13				
14				
15				
16				
17				
18				
19				
20				
21				
22				
23				
24				
25				
26				
27				
28				
29				

30				
31				
32				
33				
34				
35				

*Vërejtje;*

*Me nënshkrimin tim në listën e komunës unë konfirmoj se komuna mund të përdorë kontaktet e ofruara nga ana ime për të më dërguar njoftime periodike për ngjarje të cilat janë në interes publik.*

*Me nënshkrimin tim konfirmoj se autoritetet e komunës mund të regjistrojnë takimin për qëllime të procesverbalit dhe të publikimit të fotografive dhe video materialeve provuese nga këto takime.*

**Podujevë**

**03.12.2024**